

D E K R E T
Nr.1492, datë 20.5.1996

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7677, DATË 3.3.1993 “PËR TATIMIN MBI FITIMIN”

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Pas nenit 4 të ligjit nr.7677, datë 3.3.1993 “Për tatimin mbi fitimin”, shtohet neni 4/1 me këtë përmbajtje:

“I nënshtrohen tatimit mbi fitimin gjithë personat juridikë e fizikë vendas e të huaj, shtetërorë a privatë, që kryejnë ose do të kryejnë një qarkullim më të madh se 2 milionë lekë në një vit kalendarik dhe që janë subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar.

Qarkullimi që merret parasysh, përfshin të gjitha veprimtaritë ekonomike të kryera nga i njëjti person dhe llogaritet në bazë të çmimit gjithsej që paguan blerësi.

Nëse personi fillon ose ndërpret veprimtaritë e tij ekonomike gjatë një viti kalendarik, qarkullimi në lidhje me kufirin 2 milionë lekë llogaritet në proporcion me kohëzgjatjen e veprimtarive.”

Neni 2

Në të gjithë ligjin ekzistues, pas fjalëve “personat juridikë” shtohen kudo fjalët “e fizikë”.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi më 1.7.1996.

KUNDËRFIRMOHET

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha

Miratuar me ligjin nr.8161, datë 7.11.1996 të Kuvendit Popullor